



Kuvendi i Komunës

Nr. 001/08

Datë: 22.03.2010

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 39.7, dhe udhëzimit Administrativ 16/2008, mbi kompensimin e stafit politik në Komuna, Kryesuesi i Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 22.03.2010, mori këtë:

VENDIM

Për Kompensimin e Këshilltarëve të Kuvendit Komunal dhe të anëtarëve të Komiteteve Obligative

Neni 1

Bazuar në udhëzimin Administrativ 16/2008, mbi kompensimin e stafit politik, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me 22.03.2010, miratoj vendimin për kompensimin e Këshilltarëve Komunal.

Neni 2

Për anëtarët e Kuvendit kompensimi maksimal është 100€, ndërsa pjesëmarrja në çdo seancë të punës së Kuvendit Komunal kompensohet si shtesë 125€.

Neni 3

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të kompensohen më shumë se për 12 seanca brenda vitit.

Neni 4

Për anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët janë edhe anëtarë të Komiteteve obligative, kompensimi maksimal mujorë është 100€

Neni 5

Pjesëmarrja në çdo seancë të Komiteteve obligative kompensohen si shtesë në lartësi prej 50€.

Neni 6

Anëtarët e Kuvendeve Komunale të përcaktuar sipas nenit 8, të UA, 16/2008,

të cilët nuk marrin pjesë në seancat e mbajtura të Kuvendit të Komunës, kompensimi mujorë i zvogëlohet për 125€.

Neni 7

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Kryesuesi i Kuvendit dhe Udhëheqësja e personelit në Komunën e Junikut.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e Kuvendit Komunal,
- Anëtarët e Komiteteve obligative,
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Sinan Gacaferi
